



Republika e Kosovës
Republika Kosova- Kosova Cumhuriyeti

Komuna e Prizrenit
Opština Prizren – Prizren Belediyesi

Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim Hapësinor
Nr: 04-353/01-29588
Dt. 31.03.2026
Prizren

DREJTORATI PËR URBANIZËM dhe PLANIFIKIM HAPËSINOR, me kërkesën e **Naser Pashtrik** nga **Prizreni** me banim në rrugën **"Xhemil Fluku" nr.11** në bazë të nenit 3alineja 1 pikat 1.5 nën-pika 1.5.3; 1.7 , 1.17. dhe nenit 5 alineja 1 pika 1.3.1 , nenin 15 alinea 1 pika 1.1 , neni 18 e lidhur me dhe nenin 19. pika 2. të Ligjit për ndërtim nr.04/L-110, si dhe nenit 16 të Ligjit për Planifikim Hapësinor nr.04/L-174 të dt.31.07.2013 , si dhe konform nenit 17 të Ligjit për Ndërtesat e Banimit në Bashkëpronësi nr.04/L-134 të datës 29.07.2013 si dhe në harmoni me dispozitat e Udhëzimit Administrativ nr.06/2017 si dhe Vendimit për përcaktimin e taksës administrative për lëshimin e lejes ndërtimore dhe tarifat për rregullimin e infrastrukturës në territorin e qytetit të Prizrenit nr.01/011-41141 të dt.10.04.2014, nenit 85 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale dhe të nenit 44,46,47,48 si dhe neneve 27dhe 125 të L.P.P.A nr. 05/031 dt. 25.05.2016 merr këtë:

VENDIM
(për Leje Shëndrimi)

Kjo Leje ndërtimore i lëshohet:			
Emri:	Naser Pashtrik		
Adresa:	"Sylejman Rotlla" nr. /		
Telefoni:		Emaili:	

Emri i projektit	Objekti – Bashkimi(ndryshimi i njësive)dhe shëndrimi i objektit banesor në lokal afarist		
Emri i projektuesit	Byroja projektuese "Elektromontimi " N.T.SH.		
Adresa:	11 Marsi L.II/A nr.2. - Prizren		
Telefoni:	+377 (0)44 113 191	Emaili:	/



Me këtë Vendim, aplikuesit për leje ndërtimore **Naser Pashtrik** i lejohet bashkimi (ndryshimi i njësisë) dhe shëndrimi i objektit banesor në lokal afarist në katin përdhës të objektit –banes kolektive në rrugën “Sylejman Rotlla” nr./ . Zona Kadastrale Prizren.

	Për punët ndërtimore në vijim	
Adresa: ZK Prizren		
Zonat (t) Kadastrale	Lokacioni gjendet në Zonën Kadastrale Prizren gjegjësisht në Zonën Urbane të Qytetit Bashkimi (ndryshimi i njësisë) dhe shëndrimi i objektit banesor në lokal afarist do të bëhet në parcelën (objektet) nr. O-71813068-51-2-1-0 me sipërfaqe S=63.14m ² ; O-71813068-51-2-2-0 me sipërfaqe S=63.14m ² dhe O-71813068-51-2-3-0 me sipërfaqe S=18.00m ² Z.K. Prizren e me sipërfaqe të tërësishme S=144.28m ² me dimensione sipas projektit. Etazhiteti i objektit –banesë kolektive është S+P+3+NK Shëndrimi bëhet në katin përdhës të objektit	GPS Koordinatat:

- Është miratuar taksa administrative për lëshimin e lejes ndërtimore në shumën prej **604.53€**

Lloji i ndërtimit të propozuar: Shëndrim <input checked="" type="checkbox"/> Rindertim <input type="checkbox"/> Ripatim <input type="checkbox"/>
Kategoria e ndërtimeve të propozuara: Kategoria I <input type="checkbox"/> Kategoria II <input type="checkbox"/>
A përfshin kërkesa ndryshimit e destinimit? Po <input type="checkbox"/>

Me këtë vendim, poseduesit të lejes ndërtimore **Naser Pashtrik** i lejohet bashkimi (ndryshimi i njësisë) dhe shëndrimi i objektit banesor në lokal afarist në katin përdhës të objektit banesor.



Poseduesi i Lejes Ndërtimore është i obliguar që:

- Të fillojë me punët ndërtimore brenda një (1) viti nga data e dhënies së kësaj leje ndërtimore. Në rast se nuk fillohet me ndërtim brenda këtij afati atëherë mund të bëhet kërkesa për vazhdim të lejes ndërtimore brenda afatit të vlefshmërisë së lejes ndërtimore;
- Të vendosë tabelen informuese në vendndërtim me informatat e mëposhtme:
 - Informata mbi Lejen Ndërtimore
 - Informatat mbi projektuesin
 - Informata mbi kontraktuesin
 - Prezantimi grafik i dukjes së ndërtimit
 - Të rrethoj vend ndërtimin (punishten)
- Të sigurojë që kontraktuesi në vendndërtim posedon dokumentet e mëposhtme:
 - Një kopje të kësaj leje ndërtimore;
 - Në kopje e të gjitha dokumenteve të ndërtimit që janë nënshkruar ose vulosur si të “APROVUAR” nga organi kompetent;
 - Projektin ;
 - Dokumentacionin që tregon konformitetin e produkteve të ndërtimit dhe pajisjeve me kërkesat rregullative, dhe me dokumentet e aprovuara të ndërtimit;
 - Librin dhe ditarin ndërtimor, që duhet të përmbajnë regjistër të hollësishëm ditor të të gjitha punëve ndërtimore, përfshirë të dhëna të shkruara dhe skematike, që dokumentojnë: datën, vendin dhe rezultatet e testeve të kryera në materialet ose punët ndërtimore;
 - Përshkrim të problemeve të hasura gjatë ndërtimit dhe inspektimit dhe mënyrën se si janë zgjidhur si dhe;
 - Kartelën e miratuara nga Drejtoria e Inspektionit – inspektoriat i ndërtimit e cila është e nevojshme për aplikim për certifikatë të përdorimit;
 - Të dorëzoj njoftim inspektoratit të Organit Kompetent për fillimin e ndërtimit së paku shtatë (7) ditë para fillimit të punëve ndërtimore;
 - Të njoftoj organin kompetent për të kryer inspektimet siç kërkohet me ligj, dhe akte nënligjore. Këto inspektime nuk e lirojnë aplikuesin për leje ndërtimore dhe/ose arkitektin apo inxhinierin e licencuar përgjegjës për sigurimin e inspektimeve adekuata dhe mikëqyrje ditore të punëve ndërtimore;
 - Të njoftoj organin kompetent për ndryshimet në dokumentacionin ndërtimor të miratuar nga projektuesi. Poseduesi i Vendimit duhet të njoftojë organin kompetent për të gjitha ndryshimet në dokumentacionin ndërtimor të miratuara nga projektuesi përveç në rast kur:



- Ndrysimet nuk janë në kundërshtin me Kushtet Ndërtimore, Kodin dhe rregulloret teknike në fuqi;
- Ndryshimet në dimensionet e pjesëve të jashtme të ndërtimit nuk tejkalojnë 2% dhe zero presje një (0,1) metër por që nuk tejkalojnë vijën ndërtimore;
- Ndryshimet në organizimin e brendshëm janë në harmoni me Kushtet Ndërtimore, Kodin dhe rregulloret teknike në fuqi;

A r s y e t i m

Aplikuesit **Naser Pashtrik** ka kërkuar nga organi kompetent **DUPH** lëshimin e Lejes **Bashkimi(ndryshimi i njërive)dhe shëndrimi i objektit banesor në lokal afarist në katin përdhesë të objektit banesor (veprimtari joshqetësuese)**.

Pas shqyrtimit të kërkesës dhe dokumentacionit , si dhe bazuar në Ligjin për Ndërtim Nr. 04/L-110, Ligjin Nr. 02/L-28 të Procedurës Administrative dhe dispozitat tjera të ligjit në fuqi, u konstatua se janë plotësuar të gjitha kushtet e parapara ligjore për lëshimin e Vendimit.


Ky Vendim bazohet në shqyrtimin e provave:

- Njoftim për plotësim të dokumentacionit
- Marëveshja-pëlqimi i noterizuar i bashkëpronarëve të objektit mbi 50% (sipërfaqes së përgjithshme të ndërtesës)
- Projekti i gjendjes ekzistuese dhe gjendjes së re
- Fletëpagesa e taksave për rregullimin e tokës ndërtimore
- Kopje të projektit kryesor dhe kopje elektronike

Udhëzimi juridik: pala e pakënaqur me këtë aktvendim, përmes kësaj Drejtorie me ankesë mund t'i drejtohet MMPHI-së, brenda afati prej 30 ditësh duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të këtij Vendimi.

DREJTORIA E URBANIZMIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR

Bashkëpunëtor profesional:


 Xhejlane Gjini, inxhi. dip. ark.

